

NJOFTIM PËR VENDE TË LIRA PUNE

Instituti i Statistikave (INSTAT), kërkon të punësojë Specialist me Kontratë Pune në pozicionin “**Supervizor IT**” për plotësimin e nevojave me punonjës mbështetës për kryerjen e aktivitetit “CENS-it të Popullsisë dhe Banesave 2020”.

Përshkrimi i punës dhe kriteret për pozicionin Supervizorët TI në njësinë TI për Censin e Popullsisë dhe Banesave 2020

Misioni

Përgjegjës për funksionimin dhe përdorimin e duhur të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave në terren të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020. Mbështet stafin e terrenit në lidhje me përdorimin e kësaj infrastrukture nëpërmjet dhënies së asistencës teknike.

Qëllimi i pozicionit të punës

Duke marrë në konsideratë strukturën komplekse të Censit në terren dhe përfshirjen e një numri të madh të stafit në terren, suksesi i procesit të grumbullimit të të dhënave do të varet shumë nga përdorimi efektiv i sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Supervizorët TI të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020 monitorojnë funksionimin dhe përdorimin e duhur të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave nga stafi i terrenit. Përgjigjen para Përgjegjësit e Njesisë Bashkiake për çështje administrative dhe Drejtuesit të Njesisë së TI të Censit për mirëmbajtjen/përdorimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit në përputhje me kërkesat dhe nevojat e përdoruesve të këtyre sistemeve.

Detyrat e supervizorit IT

- Instaloni, konfiguroni, mirëmban tabletat/paisjet kompjuterike në përdorim nga stafi i terrenit;
- Jep zgjidhje në lidhje me çështjet teknike për problematikat që ndesh stafi i terrenit (anketues/kontrollorë/mbikqyrës);
- Mbështet stafin e terrenit në lidhje me përdorimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit nëpërmjet asistencës teknike;
- Merr pjesë në trajnim;
- Merr pjesë në përzgjedhjen e stafit kontrollor/anketues;
- Sigurohet që të ketë komunikim të vazhdueshëm me stafin e terrenit, Përgjegjësit të Njesisë Bashkiake dhe Drejtuesin e Njesisë së TI të Censit;
- Trajnon anketuesit/kontrollorët për përdorimin e TI;

- Sigurohet që anketuesit/kontrollorët përdorin infrastrukturën e TI sic duhet gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave;
- Raporton çdo problem serioz tek kreu i njësive TI sa më shpejtë të jetë e mundur;
- U përgjigjet kërkesave të përdoruesve për asistencë. Identifikon burimin e problemit (software/hardware ose gabim anketuesi/kontrollori) dhe zgjidh problemin, e referon dhe e diskuton problemin me Njësinë TI të Censit;
- Kryen detyra të tjera që mund t'i ngarkohen.

Për punën e terrenit INSTAT do të rekrutojë kryesisht **7 Supervizorë IT** “vendas” (banorë të Bashkive/[njësive administrative](#)) duke siguruar të gjitha kërkesat e nevojshme sipas tabelës së mëposhtme:

Qarku	Njësitë administrative përbërëse	Karakteristikat e zones	Specialist IT
Durrës	Durrës		
	Durrës	Urbane	1
	Katund i ri	Rurale	
	Rrashbull	Rurale	
Korcë	Maliq		
	Maliq	Urbane	1
	Gorrë	Rurale	
	Vreshtas	Rurale	
	Pojan	Rurale	
	Pustec		
	Liqenas	Rurale	
	Kolonjë		
	Ersekë	Urbane	1
	Leskovik	Rurale	
	Çlirim	Rurale	
	Q.Leskovik	Urbane	
	Mollas	Rurale	
Kukës	Kukës		
	Kukës	Urbane	1
	Shishtavec	Rurale	
	Ujmisht	Rurale	
	Zapod	Rurale	
Shkodër	Shkodër		
	Shkodër	Urbane	1
	Postribë	Rurale	
	Rrethina	Rurale	
	Mal.Madhe		
	Koplik	Urbane	
Tiranë	Tiranë		
	Tiranë	Urbane	1
	Farkë	Rurale	

	Dajt	Rurale	
	Shrëngjergj	Rurale	
	Vaqarr	Rurale	
Vlorë	Vlorë		1
	Vlorë	Urbane	
	Orikum	1Urbane / 2 Rurale	
	Himarë		
	Himarë	Rurale	
			7

Aftësitë

Duhet të zotërojnë aftësitë e mëposhtme:

- Aftësia shumë të mira në përdorimin e pajisjeve kompjuterike, në mënyrë të veçantë tablet;
- Aftësia shumë të mira në instalimin, konfigurimin e tabletëve;
- Aftësi për të zgjidhur problemet e ndryshme software/hardware apo gabime njerëzore.

Kualifikime dhe Eksperienca

Arsimi: Bachelor preferohet fusha e studimeve Informatikë, Informatikë Ekonomike, Inxhinieri Informatike, ose fusha të ngjashme.

Aftësi të tjera

- Të jetë bashkëpunues;
- Të jetë i aftë të punojë në grup;
- Të jetë i aftë të menaxhojë situata të paparashikuara;
- Të ketë aftësi të ndërtojë marrëdhënie efektive të punës me stafin e projektit dhe partnerët;
- Të jetë kreativ dhe fleksibël gjatë performacës së tij;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe prezantuese.

Fushat e Njohurive

Njohuri në fushën e TI –së për konfigurim /instalim të pajisjeve TI, në veçanti tablet, instalim software sipas kërkesave, instalim pajisjesh të tjera kompjuterike. Aftësi për të identifikuar problematika dhe dhënie zgjidhjesh mbështetur në përvojën profesionale, aftësi për të vlerësuar opsione të ndryshme dhe parashikuar pasojat nga zgjedhja e tyre.